




# Manuali i instalimit



## Sky Air Advance-series




**RZASG100MUV  
RZASG125MUV  
RZASG140MUV**

**RZASG100MUY  
RZASG125MUY  
RZASG140MUY**


Manuali i instalimit  
Sky Air Advance-series

**Shqip**



A~E	H <sub>B</sub> H <sub>D</sub> H <sub>U</sub>	(mm)							
		a	b	c	d	e	e <sub>B</sub>	e <sub>D</sub>	
B	—		≥100						
A, B, C	—	≥250	≥100	≥100					
B, E	—		≥100			≥1000		≤500	
A, B, C, E	—	≥250	≥150	≥150		≥1000		≤500	
D	—				≥500				
D, E	—				≥500	≥1000	≤500		
B, D	—		≥100		≥500				
B, D, E	H <sub>B</sub> < H <sub>D</sub>	H <sub>B</sub> ≤ ½H <sub>U</sub>	≥250		≥750	≥1000	≤500		
		½H <sub>U</sub> < H <sub>B</sub> ≤ H <sub>U</sub>	≥250		≥1000	≥1000	≤500		
	H <sub>B</sub> > H <sub>D</sub>	H <sub>B</sub> > H <sub>D</sub>	⊘						
		H <sub>D</sub> ≤ ½H <sub>U</sub>	≥100		≥1000	≥1000		≤500	
	½H <sub>U</sub> < H <sub>D</sub> ≤ H <sub>U</sub>	≥200		≥1000	≥1000		≤500		
	H <sub>D</sub> > H <sub>U</sub>	⊘							



1



A, B, C	—	≥250	≥300	≥1000					
A, B, C, E	—	≥250	≥300	≥1000		≥1000		≤500	
D	—				≥1000				
D, E	—				≥1000	≥1000	≤500		
B, D	H <sub>D</sub> > H <sub>U</sub>	≥300		≥1000					
	H <sub>D</sub> ≤ ½H <sub>U</sub>	≥250		≥1500					
	½H <sub>U</sub> < H <sub>D</sub> ≤ H <sub>U</sub>	≥300		≥1500					
B, D, E	H <sub>B</sub> < H <sub>D</sub>	H <sub>B</sub> ≤ ½H <sub>U</sub>	≥300		≥1000	≥1000	≤500		
		½H <sub>U</sub> < H <sub>B</sub> ≤ H <sub>U</sub>	≥300		≥1250	≥1000	≤500		
	H <sub>B</sub> > H <sub>D</sub>	H <sub>B</sub> > H <sub>D</sub>	⊘						
		H <sub>D</sub> ≤ ½H <sub>U</sub>	≥250		≥1000	≥1000		≤500	
	½H <sub>U</sub> < H <sub>D</sub> ≤ H <sub>U</sub>	≥300		≥1000	≥1000		≤500		
	H <sub>D</sub> > H <sub>U</sub>	⊘							





1+2

1



H <sub>B</sub> H <sub>U</sub>	b (mm)
H <sub>B</sub> ≤ ½H <sub>U</sub>	b ≥ 250
½H <sub>U</sub> < H <sub>B</sub> ≤ H <sub>U</sub>	b ≥ 300
H <sub>B</sub> > H <sub>U</sub>	⊘

2



3

## Tabela e përmbajtjes

<b>1 Rreth këtij dokumenti</b>	<b>3</b>
<b>2 Udhëzimet specifike për sigurinë e instaluesit</b>	<b>3</b>
<b>3 Rreth kutisë</b>	<b>5</b>
3.1 Njësia e jashtme .....	5
3.1.1 Heqja e aksesorëve nga njësia e jashtme .....	5
<b>4 Instalimi i njësisë</b>	<b>5</b>
4.1 Përgatitja e vendit të instalimit .....	5
4.1.1 Kërkesat e vendit të instalimit për njësinë e jashtme ..	5
4.2 Hapja dhe mbyllja e njësisë .....	6
4.2.1 Hapja e njësisë së jashtme .....	6
4.2.2 Mbyllja e njësisë së jashtme .....	6
4.3 Fiksimi i njësisë së jashtme .....	7
4.3.1 Sigurimi i strukturës së instalimit .....	7
4.3.2 Instalimi i njësisë së jashtme .....	7
4.3.3 Sigurimi i kullimit .....	7
4.3.4 Parandalimi i rrëzimit të njësisë së jashtme .....	8
<b>5 Instalimi i tubacionit</b>	<b>8</b>
5.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit .....	8
5.1.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e jashtme ...	8
5.2 Kontrolli i tubacionit të ftohësit .....	10
5.2.1 Kontrolli i tubacionit të ftohësit: Instalimi .....	10
5.2.2 Kryerja e një testimi të rrjedhjes .....	10
5.2.3 Tharje me vakum .....	10
<b>6 Instalimi elektrik</b>	<b>10</b>
6.1 Rreth pajisjes elektrike .....	11
6.2 Udhëzimet kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike .....	11
6.3 Specifikimet e përbërësve të instalimit standard elektrik .....	11
6.4 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e jashtme .....	11
<b>7 Ngarkimi i ftohësit</b>	<b>12</b>
7.1 Rreth ftohësit të ngarkimit .....	12
7.2 Rreth ftohësit .....	13
7.3 Ftohës me mbushje shtesë .....	14
7.3.1 Për të përcaktuar sasinë shtesë të ftohësit .....	14
7.3.2 Ngarkimi i ftohësit: Instalimi .....	14
7.3.3 Ngarkimi i ftohësit shtesë .....	14
7.4 Ftohës me rimbushje të plotë .....	14
7.4.1 Përcaktimi i sasisë së plotë të ringarkimit .....	14
7.4.2 Për të aktivizuar/çaktivizuar cilësimin e fushës së modalitetit të vakuimit .....	15
7.4.3 Ngarkimi i ftohësit: Instalimi .....	15
7.4.4 Ringarkimi i plotë i ftohësit .....	15
7.5 Për të ngjitur etiketën e gazeve serrë të fluorinuara .....	15
<b>8 Përfundimi i instalimit të njësisë së jashtme</b>	<b>15</b>
8.1 Izolimi i tubacionit të ftohësit .....	15
8.2 Kontrolli i rezistencës së izolimit të kompresorit .....	16
<b>9 Vënia në punë</b>	<b>16</b>
9.1 Lista e plotë para komisionimit .....	16
9.2 Kryerja e një testimi .....	16
9.3 Kodet e gabimit kur kryen testimin .....	17
<b>10 Hedhja</b>	<b>18</b>
<b>11 Të dhënat teknike</b>	<b>19</b>
11.1 Hapësira e shërbimit: Njësia e jashtme .....	19
11.2 Diagrami i tubacionit: Njësia e jashtme .....	20
11.3 Diagrami i instalimeve: Njësia e jashtme .....	21

## 1 Rreth këtij dokumenti

## Audienca e synuar

Instaluesit e autorizuar



## INFORMACION

Kjo pajisje ka për synim përdorimin nga ekspertë ose përdorues të trajnuar në dyqane, në industrinë e lehtë dhe ferma, ose për përdorim tregtar nga joprofesionistët.

## Seti i dokumentacionit

Ky dokument është pjesë e setit të dokumentacionit. Seti i plotë përbëhet nga:

- **Masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë:**

- Udhëzimet që DUHET të lexoni mbi sigurinë para instalimit
- Format: Letër (te kutia e njësisë së jashtme)

- **Manuali i instalimit të njësisë së jashtme:**

- Udhëzimet e instalimit
- Format: Letër (te kutia e njësisë së jashtme)

- **Udhëzuesi referencë i instaluesit:**

- Përgatitja e instalimit, të dhënat referencë, ...
- Format: Skedarët digjitalë në <https://www.daikin.eu>. Përdorni funksionin e kërkimit 🔍 për të gjetur modelin tuaj.

Rishikimi më i fundit i dokumentacionit të dhënë botohet në faqen rajonale Daikin të internetit dhe vihet në dispozicion përmes shitësit tuaj.

Udhëzimet origjinale janë të shkruara në anglisht. Të gjitha gjuhët e tjera janë përkthime të udhëzimeve origjinale.

## Të dhënat inxhinierike teknike

- Një **nëngrup** i të dhënave më të fundit teknike disponohen në faqen rajonale të internetit Daikin (e aksesueshme nga publiku).
- **Grupi i plotë** i të dhënave më të fundit teknike disponohen në Daikin Business Portal (kërkohet vërtetimi).

## 2 Udhëzimet specifike për sigurinë e instaluesit

Zbatoni gjithmonë udhëzimet për sigurinë dhe rregullat vijuese.

## Vendi i instalimit (shihni "4.1 Përgatitja e vendit të instalimit" [▶ 5])



## PARALAJMËRIM

Ndiqni përmasat hapësirës së shërbimit në këtë manual për ta instaluar njësinë si duhet. Shikoni "4.1.1 Kërkesat e vendit të instalimit për njësinë e jashtme" [▶ 5].



## PARALAJMËRIM

Pajisa do të ruhet në një dhomë pa burime ndezjesh me operim të vazhdueshëm (shembull: flakë të hapura, një pajisje me gaz ose një ngrohës me energji elektrike).



## KUJDES

Pajisja NUK është e aksesueshme nga publiku i gjerë, ndaj instaloheni në një vend të sigurt e të mbrojtur nga një akses i lehtë.

Kjo njësi, si brenda dhe jashtë, është e përshtatshme për instalim në një ambient tregtar dhe disi industrial.

## 2 Udhëzimet specifike për sigurinë e instaluesit

Hapja dhe mbyllja e njësisë (shihni "4.2 Hapja dhe mbyllja e njësisë" [p 6])



**RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI**



**RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE**



**RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE**

MOS e lini njësinë të pambikëqyrrur kur hiqet kapaku i servisit.

Montimi i njësisë së jashtme (shikoni "4.3 Fiksimi i njësisë së jashtme" [p 7])



**PARALAJMËRIM**

Mënyra e fiksimit të njësisë së jashtme DUHET të jetë në përputhje me udhëzimet nga ky manual. Shikoni "4.3 Fiksimi i njësisë së jashtme" [p 7].

Instalimi i tubacionit (shihni "5 Instalimi i tubacionit" [p 8])



**RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI**



**PARALAJMËRIM**

Tubacioni në terren DUHET të jetë në përputhje me udhëzimet nga ky manual. Shikoni "5.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit" [p 8].



**PARALAJMËRIM**

Merr masa të përshtatshme për të parandaluar që njësia të përdoret si strehë nga kafshë të vogla. Kafshët e vogla që bien në kontakt me pjesët elektrike mund të shkaktojnë ndërprerjen e funksionit, tym ose zjarr.

Instalimi elektrik (shihni "6 Instalimi elektrik" [p 10])



**RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE**



**PARALAJMËRIM**

Lidhjet elektrike DUHET të jenë në përputhje me udhëzimet nga:

- Ky manual. Shikoni "6 Instalimi elektrik" [p 10].
- Skema e instalimeve elektrike, e cila ofrohet me njësinë dhe gjendet te kapaku i kutisë së shërbimit. Për përkthimin e legjendës, shikoni "11.3 Diagramin e instalimeve: Njësia e jashtme" [p 21].



**PARALAJMËRIM**

GJITHMONË përdor kablllo me shumë bërthama për kabllot e furnizimit me energji elektrike.



**PARALAJMËRIM**

- Të gjitha instalimet elektrike DUHEN kryer nga një electricist i autorizuar dhe DUHET të pajtohen me rregulloren kombëtare të instalimeve elektrike.
- Kryeni lidhjet elektrike tek instalimet e montuara.
- Të gjithë komponentët e prokuruar në vend dhe të gjitha punimet elektrike DUHET të përputhen me legjislacionin në fuqi.



**PARALAJMËRIM**

- Nëse furnizimit me energji elektrike i mungon faza-N ose është e gabuar, pajisja mund të prishet.
- Vendos tokëzimin e duhur. MOS e tokëzoni njësinë të tubat e shërbimeve utilitare, përthithësi i fryrjeve apo tokëzimet e telefonit. Tokëzimi i paplotë mund të shkaktojë goditje elektrike.
- Instalo siguresat e kërkuara ose siguresat e qarkut.
- Siguroji instalimet elektrike me lidhëse kabllorsh që kabllot të mos bin në kontakt me tehet e mprehta apo tubacionin, veçanërisht në anën e presionit të lartë.
- MOS përdorni tela të ngjitur, kordona zgjatues ose lidhje nga një sistem yjesh. Ato mund të shkaktojnë mbinxehje, goditje elektrike ose zjarr.
- MOS e instaloni kondensatorin për përparimin e fazës, sepse kjo pajisje është e pajisur me një inverter. Kondensatori për përparimin e fazës ul performancën dhe mund të shkaktojë aksidente.



**PARALAJMËRIM**

Nëse kordoni i korrentit është i dëmtuar, DUHET të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të ngjashëm të kualifikuar për të shmangur një rrezik.



**PARALAJMËRIM**

Merr masa të përshtatshme për të parandaluar që njësia të përdoret si strehë nga kafshë të vogla. Kafshët e vogla që bien në kontakt me pjesët elektrike mund të shkaktojnë ndërprerjen e funksionit, tym ose zjarr.



**KUJDES**

MOS e shtyni apo mos e vini kabllon e mbetur në njësi.



**KUJDES**

Për përdorimin e njësive në aplikime me parametra me alarm për temperaturën rekomandohet parashikimi i një vonese prej 10 minutash për sinjalizimin e alarmit në rast se tejkalohet temperatura. Njësia mund të ndalojë për disa minuta gjatë operimit normal për "heqjen e akullit në pajisje", ose kur është nën përdorimin me "termostat të ndaluar".

Ngarkimi i ftohësit (shihni "7 Ngarkimi i ftohësit" [p 12])



**PARALAJMËRIM**

Ngarkimi i ftohësit DUHET të jetë në përputhje me udhëzimet nga ky manual. Shikoni "7 Ngarkimi i ftohësit" [p 12].



**PARALAJMËRIM**

Disa pjesë të qarkut të ftohësit mund të izoloohen nga pjesë të tjera shkaktuar nga përbërës me funksione specifike (p.sh. valvulet). Prandaj qarku i ftohësit ka porta shtesë shërbimi për pastrimin me vakum, çlirimin e presionit ose ruajtjen e tij në qark.

Në rast se kërkohet kryerja e **ngjitjes** në njësi, sigurohuni që nuk ka presion të mbetur brenda njësisë. Presionet e brendshme kanë nevojë të çlirohen me TË GJITHA portat e shërbimit të hapura siç tregohet në figurat më poshtë. Vendndodhja është në varësi të llojit të modelit.



**ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË**

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

**PARALAJMËRIM**

- Ftohësi brenda njësisë është pak i djegshëm, por normalisht NUK shkakton rrjedhje. Nëse ftohësi rrjedh në dhomë dhe bie në kontakt me zjarrin nga një djegës, ngrohëse apo furnelë, kjo mund të shkaktojë zjarr ose formimin e një gazi të dëmshëm.
- FIKNI çdo pajisje ngrohëse të djegshme, ajrosni dhomën dhe kontaktoni distributorin ku keni blerë njësinë.
- MOS e përdorni njësinë derisa një person shërbimit të konfirmojë që pjesa nga e cila ka rrjedhë ftohësi është riparuar.

**PARALAJMËRIM**

Pajisa do të ruhet në një dhomë pa burime ndezjesh me operim të vazhdueshëm (shembull: flakë të hapura, një pajisje me gaz ose një ngrohës me energji elektrike).

**PARALAJMËRIM**

- MOS i shpo apo digj pjesët e ciklit të ftohësit.
- MOS përdor materiale pastrimi ose mjete për të përshpejtuar procesin e heqjes së akullit ndryshe nga ato që rekomandohen nga prodhuesi.
- Ki parasysh që ftohësi brenda sistemit është pa aromë.

**PARALAJMËRIM**

- Përdorni vetëm R32 si ftohës. Substancat e tjera mund të shkaktojnë shpërthime dhe aksidente.
- R32 përmban gazra serë të fluoruara. Vlera e tyre për ndikuar të ngrohja globale (GWP) është 675. MOS i lëshoni këto gazra në atmosferë.
- Kur ngarkoni ftohësin, përdorni GJITHMONË doreza dhe syze mbrojtëse.

Komisionimi (shihni "9 Vënia në punë" [p 16])

**PARALAJMËRIM**

Vënia në përdorim DUHET të jetë në përputhje me udhëzimet nga ky manual. Shihni "9 Vënia në punë" [p 16].



## 3 Rreth kutisë

Mbani këto parasysh:

- Njësia DUHET të kontrollohet për dëmtime dhe plotësi gjatë dorëzimit. Çdo dëmtim ose pjesë që mungon DUHET t'i raportohet menjëherë agjentit të ankesave të operatorit.
- Sill njësinë e paketuar sa më afër të jetë e mundur te pozicioni final i instalimit për të parandaluar dëmtimin gjatë transportimit.
- Përgatitni paraprakisht rrugën gjatë të cilës dëshironi të sillni njësinë në pozicionin e saj përfundimtar të instalimit.

## 3.1 Njësia e jashtme

### 3.1.1 Heqja e aksesorëve nga njësia e jashtme



- a Masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë
- b Manuali i instalimit të njësisë së jashtme
- c Shtesa (LOTI 21)
- d Etiketa e gazrave serë të fluoruara
- e Etiketa e energjisë
- f Lidhëse

## 4 Instalimi i njësisë

### 4.1 Përgatitja e vendit të instalimit

**PARALAJMËRIM**

Pajisa do të ruhet në një dhomë pa burime ndezjesh me operim të vazhdueshëm (shembull: flakë të hapura, një pajisje me gaz ose një ngrohës me energji elektrike).

#### 4.1.1 Kërkesat e vendit të instalimit për njësinë e jashtme

Kujdes nga direktivat e hapësirës. Shikoni kapitullin "Të dhënat teknike" dhe figurat në brendësi të kopertinës.

**INFORMACION**

Niveli i presionit të zërit është më pak se 70 dBA.

**KUJDES**

Pajisa NUK është e aksesueshme nga publiku i gjerë, ndaj instalojeni në një vend të sigurt e të mbrojtur nga një akses i lehtë.

Kjo njësi, si brenda dhe jashtë, është e përshtatshme për instalim në një ambient tregtar dhe disi industrial.


Njësia e jashtme është projektuar vetëm për instalim jashtë dhe këto temperatura ambienti:

Modaliteti i ftohjes	Modaliteti i ngrohjes
-15~46°C DB	-15~15,5°C WB


## 4 Instalimi i njësisë

### 4.2 Hapja dhe mbyllja e njësisë

#### 4.2.1 Hapja e njësisë së jashtme


	<b>RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE</b>
	<b>RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI</b>

1 Hapni kapakun e shërbimit.




2 Nëse është e nevojshme, hiqni pllakën para të hyrjes së tubacionit. Kjo nevojitet për këto raste:

- "5.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit" [p. 8].
- "6.4 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e jashtme" [p. 11].
- "7 Ngarkimi i ftohësit" [p. 12].




3 Nëse është e nevojshme, hiqni pllakën mbrapa të hyrjes së tubacionit. Kjo nevojitet për këto raste:

- "5.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit" [p. 8].
- "6.4 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e jashtme" [p. 11].



4 Nëse është e nevojshme, hapni kapakun mbrapa. Kjo nevojitet për këto raste:

- "6.4 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e jashtme" [p. 11].
- "7 Ngarkimi i ftohësit" [p. 12].





#### NJOFTIM

Përdorni një kaçavidë minus për të hequr pllakën e fiksimit të termistorit (2).


KURRË mos e hiqni kapakun që mbulon trupin e termistorit.

#### 4.2.2 Mbyllja e njësisë së jashtme

1 Instaloni sërish pllakën para dhe mbrapa të marrjes së tubacionit.




2 Instaloni sërish kapakun mbrapa.



### NJOFTIM

Kujdesuni të montoni saktë gremçat e pllakës së fiksimit të termistorit (2) në kapakun mbrapa.


3 Instaloni sërish kapakun e shërbimit.



## 4.3 Fiksimi i njësisë së jashtme

### 4.3.1 Sigurimi i strukturës së instalimit

Përgatitni 4 komplete bulonash ancorimi, dado dhe rondela (furnizim jashtëkontraktor) si vijon:




[mm]

a Sigurohuni të mos mbuloni vrimat e kullimit të pllakës së fundit të njësisë.



### INFORMACION

Lartësia e rekomanduar e pjesës së sipërme të bulonave është 20 mm.




### NJOFTIM

Fiksoni njësinë e jashtme me bulonat e bazamentit duke përdorur dado me rondela të sheshta (a). Nëse është hequr veshja e zonës së shtrëngimit, metali mund të ndryshket lehtësisht.



### 4.3.2 Instalimi i njësisë së jashtme



### 4.3.3 Sigurimi i kullimit




### INFORMACION

Nëse është e nevojshme, ju mund të përdorni një tapë kullimi (furnizim jashtëkontraktor) për të parandaluar pikimin e ujit të kullimit.




### NJOFTIM

Nëse vrimat e kullimit të njësisë së jashtme mbulohehen nga një bazë montimi apo nga sipërfaqja e dyshemesë, ngrijeni njësinë për të krijuar hapësirë të lirë prej më shumë se 150 mm poshtë njësisë së jashtme.



Vrimat e kullimit (dimensionet në mm)



A Ana e shkarkimit


## 5 Instalimi i tubacionit

- B Distanca mes pikave të ankorimit
- C Korniza fundore
- D Vrimat e kullimit
- E Shpuesi metalik për dëborën

### Borë

Në rajone me rënie dëbore, dëbora mund të grumbullohet dhe të ngrijë mes shkëmbyesit të nxehtësisë dhe pllakës së jashtme. Kjo mund të ulë efikasitetin e operimit. Për të parandaluar këtë:

- 1 Hiqni vrimën nokaut (a) duke goditur lehtë mbi pikat e bashkimit me një kaçavidë minus dhe çekiç.




- 2 Hiqni gërvimat, dhe lyeni buzët dhe zonat përreth buzëve duke përdorur bojë riparimi për të parandaluar ndryshkun.

### 4.3.4 Parandalimi i rrëzimit të njësisë së jashtme

Në rast se njësia instalohet në vende ku era e fortë mund të anojë njësinë, merrni këto masa:

- 1 Përgatitni 2 kablo siç tregohet në ilustrimin vijues (furnizuar nga klienti).
- 2 Vendosni 2 kablo mbi njësinë e jashtme.
- 3 Vendosni një fletë shtresë gome mes kabllove dhe njësisë së jashtme për të penguar kabllo të gërvishin bojën (furnizuar nga klienti).
- 4 Bashkoni fundet e kabllove.
- 5 Shtërëngoni kabllo.



## 5 Instalimi i tubacionit

### 5.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit




**RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI**

#### 5.1.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e jashtme

Mbani këto parasysh:

- **Gjatësia e tubacionit.** Mbajeni tubacionin e terrenit sa më shkurt të jetë i mundur.
- **Mbrojtja e tubacionit.** Mbroni tubacionin e terrenit nga dëmtimi fizik.

Tubacionin e ftohësit mund ta drejtoni për në pjesën para, në fund, anash ose mbrapa të njësisë.




- a Lidhja para
- b Lidhja në fund
- c Lidhja anash
- d Lidhja mbrapa

- 1 Hiqni pllakat e mëposhtme:



Për detaje, shikoni "[4.2.1 Hapja e njësisë së jashtme](#)" [▶ 6].

- Hiqni kapakun e shërbimit (a) dhe pllakën para të marrjes së tubacionit (b).
- Në rast se tubacioni i ftohësit drejtohet për nga ana mbrapa e njësisë, hiqni edhe pllakën mbrapa të marrjes së tubacionit (c).



- a Kapaku i shërbimit
- b Pllaka para e marrjes së tubacionit
- c Pllaka mbrapa e marrjes së tubacionit

- 2 Hiqni vrimën nokaut (a) në pllakën në fund ose në pllakën e marrjes së tubacionit duke goditur lehtë mbi pikat e bashkimit me një kaçavidë të vogël minus dhe çekiç. Mundësisht, pritni të çarat (b) me një sharrë metalike.



- a Shpues vrimash për tubacionin
- b Çarja





### NJOFTIM

Masat paraprake kur bëni vrima nokauti:

- Shmangni dëmtimin e kasës mbrojtëse dhe tubave poshtë.
- Pas bërjes së vrimave nokaut, ju rekomandojmë të hiqni gërvimat dhe të lyeni skajet dhe zonat rreth skajeve duke përdorur bojë riparimi për të parandaluar ndryshkun.
- Kur kaloni instalime elektrike përmes vrimave nokaut, mbështilli instalimet me ngjitëse mbrojtëse për të parandaluar dëmtimin.




### NJOFTIM

Shmangni lakimin e pllakës së fundit kur hiqni vrimën nokaut.

#### 3 Lidhni tubacionin e gazit dhe lëngut.

- Lidhni tubacionin e lëngut (a) me valvulin e ndalimit të lëngut (A).
- Lidhni tubacionin e gazit (b) me valvulin e ndalimit të gazit (B).




- A Valvuli i ndalimit (lëng)
- B Valvuli i ndalimit (gaz)
- a Tubacioni i lëngjeve
- b Tubacioni i gazrave

#### 4 Izoloni tubacionin e ftohësit:

- Izoloni tubacionin për lëngjet (a) dhe tubacionin për gazra (b).
- Kryeni izolimin e nxehtësisë së erës përreth vijave të lakimit dhe më pas mbulojeni me ngjitësi vinili (e).
- Sigurohuni që tubacioni në terren nuk prek asnjë përbërës të kompresorit (d).
- Mbyllni fundet e izolimit (izolant etj.) (c).


#### Shembull: Lidhja para



- A Valvuli i ndalimit (lëng)
- B Valvuli i ndalimit (gaz)
- a Tubacioni i lëngjeve

- b Tubacioni i gazrave
- c Fundet e izolimit
- d Kompresori
- e Ngjitës vinili

#### Shembull: Lidhja mbrapa



- A Valvuli i ndalimit (lëng)
- B Valvuli i ndalimit (gaz)
- a Tubacioni i lëngjeve
- b Tubacioni i gazrave
- c Fundet e izolimit
- d Kompresori
- e Ngjitës vinili

- 5 Nëse njësia e jashtme instalohet mbi njësinë e brendshme, mbulonni valvulet e ndalimit (A,B shikoni sipër) me material izolues për të penguar ujin e kondensuar të valvulet e ndalimit që të kalojë në njësinë e brendshme.




### NJOFTIM

Çdo tubacion i ekspozuar mund të shkaktojë kondensim.


- 6 Ringjithni kapakun e shërbimit dhe pllakën e konsumit të tubacionit.

- 7 Izoloni të gjitha hapësirat (shembull: a) për të ndaluar borën dhe kafshët e vogla që të hyjnë në sistem.



### NJOFTIM

Mos bllokoni ventilatorët e ajrit. Kjo mund të ndikojë të qarkullimi i ajrit brenda njësisë.



### PARALAJMËRIM

Merr masa të përshtatshme për të parandaluar që njësia të përdoret si strehë nga kafshët e vogla. Kafshët e vogla që bien në kontakt me pjesët elektrike mund të shkaktojnë ndërprerjen e funksionit, tym ose zjarr.


## 6 Instalimi elektrik

### ! NJOFTIM

Sigurohuni të hapni valvulet e ndalimit pas instalimit të tubacionit të ftohësit dhe tharjes me vakum. Ekzekutimi i sistemit me valvulet e ndalimit të mbyllura mund të prishë kompresorin.

## 5.2 Kontrolli i tubacionit të ftohësit

### 5.2.1 Kontrolli i tubacionit të ftohësit: Instalimi



- A Instalimi në rastin e çiftit
- B Instalimi në rastin e dyshes
- a Matës presioni
- b Nitrogjen
- c Ftohësi
- d Shkalla e peshimit
- e Pompa e vakumit
- f Valvul ndalimi
- g Tubacioni kryesor
- h Kutia e degëzimit të ftohësit
- i Tubacioni i degëzimit

### 5.2.2 Kryerja e një testimi të rrjedhjes

Testimi i rrjedhjes duhet të përmbushë specifikimet e EN378-2.

#### Testimi i rrjedhjes nga presioni

### ! NJOFTIM

MOS e tejkaloni presionin maksimal të punës së njësisë (shikoni "PS High" në pllakën e emërimit të njësisë).

- Ngarkoni sistemin me gaz nitrogjeni derisa presioni i matësit të jetë të paktën 0,2 MPa (2 atmosferë). Rekomandohet rritja e presionit në 3,0 MPa (30 atmosferë) për të kapur rrjedhjet e vogla.
- Kontrolloni për rrjedhje duke përdorur zgjidhjen e testimit me fluska për të gjitha lidhjet.

### ! NJOFTIM

GJITHMONË përdor një zgjidhje të rekomanduar testimi me fluskë nga grosisti yt.

KURRË mos përdor ujë me sapun:

- Uji me sapun mund të shkaktojë plasaritje të përbërësve, si dadon e zgjerimit ose kasketën e valvulit të ndalimit.
- Uji me sapun mund të përmbajë kripë, e cila thith lagështinë që do të ngrihet kur tubacioni ftohet.
- Uji me ujë përmban amoniak, i cili mund të çojë në gërryerjen e njeve ngjeshëse (mes dados ngjeshëse të tunxhit dhe flakërimit të bakrit).

- Shkarkoni të gjithë gazin nitrogjen.

### 5.2.3 Tharje me vakum

### ! NJOFTIM

- Lidhni pompën e vakuumit me të dyja portat e shërbimit të valvulit të ndalimit të gazit dhe portën e shërbimit të valvulit të ndalimit të lëngut për të rritur efikasitetin.
- Sigurohuni që valvuli i ndalimit të gazit dhe të lëngut janë të mbyllura mirë para kryerjes së testimit të rrjedhjes apo tharjes me vakuum.

- Zbrazni sistemin derisa presioni në kolektor të tregojë -0,1 MPa (-1 bar).

- Lëreni siç është për 4-5 minuta dhe kontrolloni presionin:

Nëse presioni...	Pastaj...
Nuk ndryshon	Nuk ka lagështi në sistem. Kjo procedurë ka mbaruar.
Rritet	Në sistem ka lagështi. Kaloni në hapin tjetër.

- Zbrazni sistemin për të paktën 2 orë deri sa të arrijë presionin e kolektorit prej -0,1 MPa (-1 bar).
- Pas FIKJES së pompës, kontrolloni presionin për të paktën 1 orë.
- Nëse NUK arrini vakumin e synuar ose NUK MUND të ruani vakumin për 1 orë, bëni këto:

- Kontrolloni sërish për rrjedhje.
- Kryeni sërish tharje me vakum.

### ! NJOFTIM

Sigurohuni të hapni valvulet e ndalimit pas instalimit të tubacionit të ftohësit dhe tharjes me vakum. Ekzekutimi i sistemit me valvulet e ndalimit të mbyllura mund të prishë kompresorin.

## 6 Instalimi elektrik

**! RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE**

**! PARALAJMËRIM**  
Pajisja DUHET instaluar në përputhje me rregullat kombëtare të instalimeve elektrike.

**! PARALAJMËRIM**  
GJITHMONË përdor kablo me shumë bërthama për kabllo të furnizimit me energji elektrike.

**! PARALAJMËRIM**  
Nëse kordoni i korrentit është i dëmtuar, DUHET të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të ngjashëm të kualifikuar për të shmangur një rrezik.

**! KUJDES**  
MOS e shtyni apo mos e vini kabllon e mbetur në njësi.

**! KUJDES**  
Për përdorimin e njësive në aplikime me parametra me alarm për temperaturën rekomandohet parashikimi i një vonese prej 10 minutash për sinjalizimin e alarmit në rast se tejkalohe temperatura. Njësia mund të ndalojë për disa minuta gjatë operimit normal për "heqjen e akullit në pajisje", ose kur është nën përdorimin me "termostat të ndaluar".

## 6.1 Rreth pajisjes elektrike

### RZASG100~140MUV

Pajisja që përputhet me EN/IEC 61000-3-12 (Standardi evropian/ndërkombëtar teknik që cakton kufijtë për rrymat harmonike prodhuar nga pajisjet e lidhura me sistemet publike me voltazh të ulët dhe me rrymë inputi >16 A dhe ≤75 A për fazë.).

### RZASG100~140MUY

Pajisje që përputhen me EN/IEC 61000-3-2 (Standardin Teknik Evropian/Ndërkombëtar që cakton kufijtë për rrymat harmonike prodhuar nga pajisjet e lidhura me sistemet publike të voltazhit të ulët me rrymë inputi ≤16 A për fazë.).

## 6.2 Udhëzimet kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike

### Çifte rrotullues për shtrëngim

Artikull	Çift rrotullues për shtrëngim (N•m)
M4 (X1M)	1,2~1,8
M4 (tokëzim)	1,2~1,4
M5 (X1M)	2,0~3,0
M5 (tokëzim)	2,4~2,9



#### NJOFTIM

Nëse në terminalin e instalimeve disponohet hapësirë e kufizuar, përdorni terminalet unazë të përkulura të stilit drehë.

## 6.3 Specifikimet e përbërësve të instalimit standard elektrik

Përbërësi		RZASG100~140MUV			RZASG100~140MUY		
		100	125	140	100	125	140
Kabloja e korrentit	MCA <sup>(a)</sup>	22,7 A	29,2 A	28,5 A	14,9 A	15,7 A	15,4 A
	Gama e voltazhit	220~240 V			380~415 V		
	Faza	1~			3N~		
	Frekuenca	50 Hz					
	Madhësitë e telit	Duhet të respektojë rregulloren kombëtare të instalimeve elektrike					
		Kablo me 3 bërthama			Kablo me 5 bërthama		
		Madhësia e telit bazohet në rrymë, por jo më pak se:					
		Minimumi 4,0 mm <sup>2</sup>			Minimumi 2,5 mm <sup>2</sup>		
Kabloja e ndërlidhjes (brenda ↔ jashtë)	Voltazhi	220-240 V					
	Madhësia e telit	Përdorni vetëm tel të harmonizuar që ofrojnë izolim të dyfishtë dhe janë të përshtatshëm për voltazhin në përdorim. Kablo me 4 bërthama Minimumi 2,5 mm <sup>2</sup>					
Siguresa e rekomanduar në ambient të hapur		25 A	32 A		16 A		
Çelës i rrjedhjes së tokëzimit / pajisja reziduale korrenti		Duhet të respektojë rregulloren kombëtare të instalimeve elektrike					

<sup>(a)</sup> MCA=Kapaciteti minimal i qarkut. Vlerat e konstatuara janë vlera maksimale (shikoni të dhënat elektrike të kombinimit me njësitë e brendshme për vlera ekzakte).

**Shënim:** Kordonët e furnizimit të pjesëve të pajisjeve për përdorim jashtë nuk duhet të jenë më të lehtë se kordoni fleksibël me këllëf prej polikloropreni (emërtimi i kodit 60245 IEC 57).



#### NJOFTIM

Rekomandojmë përdorimin e telave të fortë (tek bërthamë). Nëse përdoren telat e bllokuar, rrotulloni ngadalë telat për të konsoliduar fundin e përçuesin për secilin prej përdorim të drejtpërdrejtë në kapësen e terminalit ose vendosjen në një terminal të rrumbullakët të llojit drehë. Detajet përshkruhen në "Udhëzimet kur bëni lidhjen e instalimeve elektrike" në udhëzuesin referencë të instaluesit.

2 Lidhni kabllo e ndërlidhjes dhe korrentin si më poshtë:

## 6.4 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e jashtme




#### NJOFTIM

- Ndiqui diagramin e instalimeve (dorëzuar me njësinë, që ndodhet në brendësi të kapakut të shërbimit).
- Sigurohuni që instalimet elektrike të MOS bllokohen bashkëngjitjen e duhur nga e para të kapakut të shërbimit.


1 Hiqni kapakun e shërbimit.

## 7 Ngarkimi i ftohësit



- I, II, III, IV Çift, dyshe, treshe, dyshe e dyfishtë  
 M, S Mjeshër, skllav  
 a Kabllot e ndërlidhjes  
 b Kabloja e korrentit  
 c Çelës për rrjedhje të tokëzimit  
 d Siguresa  
 e Ndërfaqja e përdoruesit

Shembull: RZASG100~140MUV




- a Kutia e ndërrimit  
 b Pllaka e ngjitjes të valvulit të ndalimit  
 c Blloku i terminalit  
 d Instalimet e tokëzimit  
 e Kabloja e korrentit  
 f Kabloja e ndërlidhjes  
 g Lidhëse

- Fiksioni kabllojtë (kabllojtë e furnizimit me energji elektrike dhe të ndërlidhjes) me një lidhëse të pllaka e ngjitjes së valvulit të ndalimit dhe drejtoni instalimet sipas ilustrimit të mësipërm.
- Zgjidhni një vrimë nokauti dhe hiqeni atë duke goditur lehtë mbi pikat e bashkimit me një kaçavidë minus dhe çekiq.
- Drejtoni instalimet elektrike përmes kornizës dhe lidhni ato me kornizën të shpuesit metalik.

Drejtoni përmes kornizës

Zgjidhni një nga 3 mundësitë:




- a Kabloja e furnizimit me energji elektrike  
 b Kabloja e ndërlidhjes

Lidhja me kornizën

Kur kabllojtë janë drejtuar nga njësia, të shpuesit metalik mund të vendoset një mbështjellëse mbrojtëse për qarqet (futjet PG).

Kur nuk përdorni një kanal për tela, mbrojni telat me tuba vinili për të penguar buzën e shpuesit metalik që të presë telat.



A Brenda njësisë së jashtme

B Jashtë njësisë së jashtme

- a Tel  
 b Unazë  
 c Dado  
 d Kornizë  
 e Zorrë



### NJOFTIM

Masat paraprake kur bëni vrima nokauti:

- Shmangni dëmtimin e kasës mbrojtëse dhe tubave poshtë.
- Pas bërjes së vrimave nokaut, ju rekomandojmë të hiqni gërvimat dhe të lyeni skajet dhe zonat rreth skajeve duke përdorur bojë riparimi për të parandaluar ndryshkun.
- Kur kaloni instalime elektrike përmes vrimave nokaut, mbështilli instalimet me ngjitëse mbrojtëse për të parandaluar dëmtimin.

6 Ringjithni kapakun e shërbimit.

7 Lidhni çelësin e qarkut të rrjedhjes së tokëzimit dhe siguresën me linjën e furnizimit me energji.

## 7 Ngarkimi i ftohësit

### 7.1 Rreth ftohësit të ngarkimit

Njësia e jashtme është e ngarkuar me ftohës që nga dalja prej fabrike, por në disa raste mund të nevojiten të mëposhtmet:

Çfarë	Kur
Ftohës me mbushje shtesë	Kur gjatësia e përgjithshme e tubacionit të lëngjeve është më e madhe nga sa përcaktohet (shikoni më vonë).

Çfarë	Kur
Ftohës me rimbushje të plotë	<b>Shembull:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kur zhvendoset sistemi.</li> <li>Pas një rrjedhjeje.</li> </ul>

**Ftohës me mbushje shtesë**

Para mbushjes së ftohësit shtesë, sigurohuni që të kontrollohet tubacioni i ftohësit të jashtëm të njësisë së jashtme (testim për rrjedhje, tharje me vakuum).

**i INFORMACION**

Në varësi të njësive dhe/ose kushteve të instalimit, mund të jetë e nevojshme lidhja e instalimeve elektrike para se të ngarkoni ftohësin.

Puna tipike – Zakonisht mbushja e ftohësit shtesë përbëhet nga fazat vijuese:

- Përcaktimi nëse dhe sa duhet mbushje shtesë duhet të kryeni.
- Nëse shihet e nevojshme, mbushet ftohësi shtesë.
- Plotësimi i etiketës së gazrave serë të fluorinuar si dhe ngjitja e saj brenda njësisë së jashtme.

**Ftohës me rimbushje të plotë**

Para mbushjes së ftohësit shtesë, sigurohuni që të kryhen veprimet vijuese:

- I gjithë ftohësi rikuperohet nga sistemi.
- Kontrollohet tubacioni i jashtëm i njësisë së jashtme (testim për rrjedhje, tharje me vakuum).
- Kryhet tharja me vakuum i tubacionit të ftohësit të brendshëm të njësisë së jashtme.

**! NJOFTIM**

Para ringarkimit të plotë, kryeni tharje me vakuum edhe në tubacionin e brendshëm të ftohësit të njësisë së jashtme.

**! NJOFTIM**


Për të kryer tharje me vakuum apo një ringarkim të plotë të tubacionit të brendshëm të ftohësit të njësisë së jashtme është i nevojshëm aktivizimi i modalitetit të vakuimit (shikoni "7.4.2 Për të aktivizuar/çaktivizuar cilësimin e fushës së modalitetit të vakuimit" [p. 15]) i cili do të hapë valvulet e kërkuara të qarku i ftohësit që procesi i boshatisjes apo ringarkimi i ftohësit të mund të kryhet si duhet.

- Para tharjes me vakuum apo ringarkimit, aktivizoni cilësimin e fushës "modaliteti i vakuimit".
- Pas përfundimit të tharjes me vakuum apo ringarkimit, çaktivizoni cilësimin e fushës "modaliteti i vakuimit".


**! PARALAJMËRIM**

Disa pjesë të qarkut të ftohësit mund të izoloohen nga pjesë të tjera shkaktuar nga përbërës me funksione specifike (p.sh. valvulet). Prandaj qarku i ftohësit ka porta shtesë shërbimi për pastrimin me vakuum, çlirimin e presionit ose ruajtjen e tij në qark.

Në rast se kërkohet kryerja e ngjitjes në njësi, sigurohuni që nuk ka presion të mbetur brenda njësisë. Presionet e brendshme kanë nevojë të çlirohen me TË GJITHA portat e shërbimit të hapura siç tregohet në figurat më poshtë. Vendndodhja është në varësi të llojit të modelit.

**4-5 HP**

- a Porta e jashtme e shërbimit  
b Valvuli i ndalimit me portën e shërbimit (lëng)  
c Valvuli i ndalimit me portën e shërbimit (gaz)

**6 HP**

- a Porta e jashtme e shërbimit  
b Valvuli i ndalimit me portën e shërbimit (lëng)  
c Valvuli i ndalimit me portën e shërbimit (gaz)

Puna tipike – Zakonisht ftohësi me rimbushje të plotë përbëhet nga fazat vijuese:

- Përcaktimi i sasisë së ftohësit për mbushje.
- Ngarkimi i ftohësit.
- Plotësimi i etiketës së gazrave serë të fluorinuar si dhe ngjitja e saj brenda njësisë së jashtme.

**7.2 Rreth ftohësit**

Ky produkt përmban gazra serë me fluor. MOS i lësho gazrat në atmosferë.

Lloji i ftohësit: R32

Vlera e mundshme e ngrohjes globale (GWP): 675

Inspektimet periodike për rrjedhjet e ftohësit mund të kërkohen në varësi të legjislacionit në zbatim. Kontaktoni instaluesin tuaj për më shumë informacion.

**ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË**

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

## 7 Ngarkimi i ftohësit



### PARALAJMËRIM

- Ftohësi brenda njësisë është pak i djegshëm, por normalisht NUK shkakton rrjedhje. Nëse ftohësi rrjedh në dhomë dhe bie në kontakt me zjarrin nga një djegës, ngrohëse apo furnelë, kjo mund të shkaktojë zjarr ose formimin e një gazi të dëmshëm.
- FIKNI çdo pajisje ngrohëse të djegshme, ajrosni dhomën dhe kontaktoni distributorin ku keni blerë njësinë.
- MOS e përdorni njësinë derisa një person shërbimit të konfirmojë që pjesa nga e cila ka rrjedhë ftohësi është riparuar.



### PARALAJMËRIM

Pajisa do të ruhet në një dhomë pa burime ndezjesh me operim të vazhdueshëm (shembull: flakë të hapura, një pajisje me gaz ose një ngrohës me energji elektrike).



### PARALAJMËRIM

- MOS i shpo apo digj pjesët e ciklit të ftohësit.
- MOS përdor materiale pastrimi ose mjete për të përshpejtuar procesin e heqjes së akullit ndryshe nga ato që rekomandohen nga prodhuesi.
- Ki parasysh që ftohësi brenda sistemit është pa aromë.

## 7.3 Ftohës me mbushje shtesë

### 7.3.1 Për të përcaktuar sasinë shtesë të ftohësit

Për të përcaktuar nëse është e nevojshme vendosja e ftohësit shtesë

Nëse	Atëherë
$(L1+L2+L3+L4+L5+L6+L7) \leq 30$ m (gjatësia pa ngarkesë)	Nuk keni pse të shtoni ftohës shtesë.
$(L1+L2+L3+L4+L5+L6+L7) > 30$ m (gjatësia pa ngarkesë)	Duhet të vendosni ftohës shtesë. Për kryerjen e servisit në të ardhmen, rrethoni sasinë e zgjedhur në tabelat e mëposhtme.



### INFORMACION

Gjatësia e tubacionit është gjatësia më e madhe me një drejtim e tubacionit për lëngje.

Për të përcaktuar sasinë e ftohësit shtesë (R në kg) (në rastin e çiftit)

	L1 (m)	
L1:	30~40 m	40~50 m
R:	0,35 kg	0,7 kg

Për të përcaktuar sasinë e ftohësit shtesë (R në kg) (në rastin e dyshes, treshes dhe dyshes së dyfishtë)

1 Përcaktoni R1 dhe R2.

Nëse	Atëherë
$G1 > 30$ m	Përdorni tabelën e mëposhtme për të përcaktuar R1
$G1 \leq 30$ m (dhe $G1+G2 > 30$ m)	$R1 = 0,0$ kg. Përdorni tabelën e mëposhtme për të përcaktuar R2

Gjatësia (gjatësia e përgjithshme e tubacionit të lëngjeve-30 m)				
0~10 m	10~20 m	20~30 m	30~40 m	40~45 m

R1:	0,35 kg	0,7 kg	1,05 kg	1,4 kg	
R2:	0,2 kg	0,4 kg	0,6 kg	0,8 kg	1 kg <sup>(a)</sup>

<sup>(a)</sup> Vetëm për RZASG100+125.

2 Përcaktoni sasinë e ftohësit shtesë:  $R=R1+R2$ .

### Shembuj

Plani	Sasia e ftohësit shtesë (R)		
	Rasti: Dysh, madhësia standarde e tubit për lëngje		
	1	G1	Totali Ø9,5 => $G1=35$ m
		G2	Totali Ø6,4 => $G2=7+5=12$ m
	2	Rasti: $G1 > 30$ m	
		R1	Gjatësia= $G1-30$ m=5 m => $R1=0,35$ kg
		R2	Gjatësia= $G2=12$ m => $R2=0,4$ kg
3	R	$R=R1+R2=0,35+0,4=0,75$ kg	
	Rasti: Tresh, madhësia standarde e tubit për lëngje		
	1	G1	Totali Ø9,5 => $G1=5$ m
		G2	Totali Ø6,4 => $G2=15+12+17=44$ m
	2	Rasti: $G1 \leq 30$ m (dhe $G1+G2 > 30$ m)	
		R1	$R1=0,0$ kg
		R2	Gjatësia= $G1+G2-30$ m = $5+44-30=19$ m => $R2=0,4$ kg
3	R	$R=R1+R2=0,0+0,4=0,4$ kg	

### 7.3.2 Ngarkimi i ftohësit: Instalimi

Shikoni "5.2.1 Kontrolli i tubacionit të ftohësit: Instalimi" [p 10].

### 7.3.3 Ngarkimi i ftohësit shtesë



### PARALAJMËRIM

- Përdorni vetëm R32 si ftohës. Substancat e tjera mund të shkaktojnë shpërthime dhe aksidente.
- R32 përmban gazra serë të fluorinuara. Vlera e tyre për ndikuar te ngrohja globale (GWP) është 675. MOS i lëshoni këto gazra në atmosferë.
- Kur ngarkoni ftohësin, përdorni GJITHMONË doreza dhe syze mbrojtëse.

**Kushti paraprak:** Para ngarkimit të ftohësit, sigurohuni që tubacioni i ftohësit është i lidhur dhe i kontrolluar (testimi i rrjedhjes dhe tharja me vakum).

- Lidhni cilindrin e ftohësit me portën e shërbimit të valvulit të ndalimit me gaz dhe portës së shërbimit të valvulit të ndalimit me lëngje.
- Ngarkoni sasi shtesë të ftohësit.
- Hapni valvulet e ndalimit.

## 7.4 Ftohës me rimbushje të plotë

### 7.4.1 Përcaktimi i sasisë së plotë të ringarkimit

Për të përcaktuar sasinë e plotë të rimbushjes (kg)

Modeli	Gjatësia <sup>(a)</sup>		
	5~30 m	30~40 m	40~50 m
RZASG100-125	2,6 kg	2,95 kg	3,3 kg
RZASG140	2,9 kg	3,25 kg	3,6 kg

<sup>(a)</sup> Gjatësia=L1 (çift); L1+L2 (dysh, tresh); L1+L2+L4 (dysh i dyfishtë)

### 7.4.2 Për të aktivizuar/çaktivizuar cilësimin e fushës së modalitetit të vakuimit


#### Përshkrimi

Për të kryer tharje me vakuum apo një ringarkim të plotë të tubacionit të brendshëm të ftohësit të njësisë së jashtme është i nevojshëm aktivizimi i modalitetit të vakuimit, i cili hap valvulet e kërkuara të qarku i ftohësit që procesi i zbrazjes apo ringarkimi i ftohësit të kryhet si duhet.

#### Për të aktivizuar modalitetin e vakuimit:

Aktivizimi i modalitetit të vakuimit kryhet duke shtypur butonat e shtyrjes BS\* të PCB-ja (A1P) dhe duke lexuar reagimin nga ekranet me 7 segmente.

Operoni çelësat dhe butonat e shtyrjes me një shkop të izoluar (siç është një stilolaps i mbyllur) për të shmangur prekjën e pjesëve me ngarkesë elektrike.



- 1 Kur vihet pajisja në korrent dhe nuk është në gjendje pune, mbani shtypur butonin BS1 për 5 sekonda.

**Rezultati:** Kur të arrini të modaliteti i cilësimit, ekrani me 7 segmente do të tregojë '2 0 0'.

- 2 Shtypni butonin BS2 derisa të arrini në faqen **2-28**.
- 3 Kur të arrihet **2-28**, shtypni një herë butonin BS3 .
- 4 Ndryshoni cilësimin në '1' duke shtypur një herë butonin BS2 .
- 5 Shtypni një herë butonin BS3.
- 6 Kur nuk pulson më ekranin, shtypni sërish butonin BS3 për të aktivizuar modalitetin e vakuimit.

#### Për të çaktivizuar modalitetin e vakuimit:

Pas ngarkimit ose zbrazjes së njësisë, çaktivizoni modalitetin e vakuimit duke e kthyer cilësimin të '0'.

Sigurohuni të ringjithni kapakun e kutisë së përbërësve elektronikë dhe të instaloni kapakun e përparmë pas mbarimit të punës.



#### NJOFTIM

Sigurohuni që të gjitha panelet e jashtme, përveç kapakut të shërbimit në kutinë e çelësit, janë të mbyllura kur punohet.

Mbyllni mirë kapakun e kutisë së çelësit para se të lëshoni energjinë.

### 7.4.3 Ngarkimi i ftohësit: Instalimi

Shikoni "5.2.1 Kontrolli i tubacionit të ftohësit: Instalimi" [p 10].

### 7.4.4 Ringarkimi i plotë i ftohësit



#### PARALAJMËRIM


- Përdorni vetëm R32 si ftohës. Substancat e tjera mund të shkaktojnë shpërthime dhe aksidente.
- R32 përmban gazra serë të fluorinuara. Vlera e tyre për ndikuar të ngrohja globale (GWP) është 675. MOS i lëshoni këto gazra në atmosferë.
- Kur ngarkoni ftohësin, përdorni GJITHMONË doreza dhe syze mbrojtëse.

**Kushti paraprak:** Para ringarkimit të plotë të ftohësit, sigurohuni që pompa e sistemit është e ulur, tubacioni i jashtëm i ftohësit të njësisë së jashtme të jetë kontrolluar (testimi i rrjedhjes, tharje me vakuum) dhe të jetë kryer tharja me vakuum e tubacionit të brendshëm i ftohësit të njësisë së jashtme.

- 1 Nëse nuk është bërë (për tharje me vakuum të njësisë), aktivizoni modalitetin e vakuimit (shikoni "7.4.2 Për të aktivizuar/çaktivizuar cilësimin e fushës së modalitetit të vakuimit" [p 15])
- 2 Lidhni cilindrin e ftohësit me portën e shërbimit të valvulit të ndalimit të lëngjeve.
- 3 Hapni valvulin e ndalimit të lëngjeve.
- 4 Ngarkoni sasinë e plotë të ftohësit.
- 5 Çaktivizoni modalitetin e vakuimit (shikoni "7.4.2 Për të aktivizuar/çaktivizuar cilësimin e fushës së modalitetit të vakuimit" [p 15]).
- 6 Hapni valvulin e ndalimit të gazrave.

### 7.5 Për të ngjitur etiketën e gazeve serrë të fluorinuara

- 1 Plotësoni etiketën si vijon:



- a Ngarkimi i ftohësit nga fabrika: shikoni pllakën e emrit të njësisë
- b Sasia shtesë e ftohësit është ngarkuar
- c Sasia e plotë e ftohësit
- d **Sasia e emetimeve të gazrave serë të fluoruar** të ngarkesës së plotë të ftohësit shprehur si tone të barasvlershme me CO<sub>2</sub>.
- e GWP = Potencial për ngrohje globale



#### NJOFTIM

Legjislacioni në fuqi për **gazrat serë me fluor** kërkon që ngarkimi i ftohësit të njësisë të tregohet si në peshë ashtu edhe në ekuivalentin CO<sub>2</sub>.

**Formula për të llogaritur sasinë në tonet ekuivalente të CO<sub>2</sub>:** Vlera GWP e ftohësit × Ngarkesa totale e ftohësit [në kg] / 1000

Përdor vlerën GWP që tregohet në etiketën e ngarkesës së ftohësit.

- 2 Ngjithni etiketën në brendësi të njësisë së jashtme. Fleta e skemës së lidhjeve elektrike ka një vend të posaçëm për ngjitjen e saj.

## 8 Përfundimi i instalimit të njësisë së jashtme

### 8.1 Izolimi i tubacionit të ftohësit

Pas përfundimit të procedurës së ngarkimit, duhet të izolohet tubacioni. Merrni parasysh këto pika:

- Sigurohuni të izoloni tubacionin e lëngjeve dhe gazrave (për të gjitha njësitë).


## 9 Vënia në punë

- Përdorni sfungjerin polietilen rezistent ndaj nxehtësisë që mund të përballojë temperatura deri në 70°C për tubacionin e lëngjeve dhe sfungjerin polietilen që mund të përballojë një temperaturë prej 120°C për tubacionin e gazrave.
- Përforconi izolimin te tubacioni i ftohësit sipas ambientit të instalimit.


Temperatura e ambientit	Lagështia	Trashësia minimale
≤30°C	Nga 75% në 80% LR	15 mm
>30°C	≥80% RH	20 mm

### Mes njësisë së jashtme dhe të brendshme

- Izoloni dhe fiksoni tubacionin e ftohësit dhe kabllojt si vijon:



- Vendosni kapakun e shërbimit.



## 8.2 Kontrolli i rezistencës së izolimit të kompresorit

### ! NJOFTIM

Nëse pas instalimit, ftohësi grumbullohet në kompresor, rezistenca e izolimit në pole mund të bjerë, por nëse është të paktën 1 MΩ, atëherë njësia nuk prishet.

- Përdorni një mega-testues 500 V kur matni izolimin.
- MOS përdorni një mega-testues për qarqet me voltazh të ulët.

- Matni rezistencën e izolimit në pole.

Nëse	Atëherë
≥1 MΩ	Rezistenca e izolimit është NË RREGULL. Kjo procedurë ka mbaruar.
<1 MΩ	Rezistenca e izolimit nuk është NË RREGULL. Kaloni në hapin tjetër.

- NDIZNI energjinë dhe lëreni për 6 orë.

**Rezultati:** Kompresori do të ngrohet dhe do të avullojë çdo ftohës në të.

- Matni sërish qëndresën e izolimit.

## 9 Vënia në punë

Ju lutemi ofroni klientit të dhënat e projektuara për mjedisin në përputhje me (EU)2016/2281. Këto të dhëna mund të gjenden te udhëzuesi referencë i instaluesit ose përmes uebfaqes së Daikin.

### ! NJOFTIM

GJITHMONË përdorni njësinë me rezistorët elektrikë dhe/ose sensorët/çelësat e presionit. Nëse JO, mund të ndodhë djegia e kompresorit.

## 9.1 Lista e plotë para komisionimit

- Pas instalimit të njësisë, kontrolloni artikujt e renditur më poshtë.
- Mbyllni njësinë.
- Ndizni njësinë.

<input type="checkbox"/>	Lexo udhëzimet e instalimit të plotë, siç përshkruhen në udhëzuesin e instaluesit të referimit.
<input type="checkbox"/>	Njësitë e brendshme janë montuar siç duhet.
<input type="checkbox"/>	Në rast se përdoret një ndërfaqe pa tel përdoruesi: Është instaluar <b>paneli i dekorimit të njësisë së brendshme</b> me marrës infra të kuq.
<input type="checkbox"/>	<b>Njësia e jashtme</b> është montuar siç duhet.
<input type="checkbox"/>	<b>Instalimet elektrike vijuese të fushës</b> janë kryer në përputhje me këtë dokument dhe legjislacionin në fuqi: <ul style="list-style-type: none"> <li>Mes panelit lokal të furnizimit dhe njësisë së jashtme</li> <li>Mes njësisë së jashtme dhe të brendshme (udhëzuese)</li> <li>Mes njësive të brendshme</li> </ul>
<input type="checkbox"/>	NUK ka <b>faza që mungojnë</b> apo <b>që kthehen mbrapsht</b> .
<input type="checkbox"/>	Sistemi është <b>tokëzuar</b> siç duhet dhe terminalet e tokëzimit janë shtrënguar.
<input type="checkbox"/>	<b>Siguresat</b> ose pajisjet e mbrojtjes të instaluara lokalisht vendosen në përputhje me këtë dokument dhe NUK kanë kaluar në rrugë anësore.
<input type="checkbox"/>	<b>Voltazhi i furnizimit me energji elektrike</b> përputhet me voltazhin në etiketën identifikuese të njësisë.
<input type="checkbox"/>	NUK ka <b>lidhje të lira</b> ose përbërës të dëmtuar elektrikë në kutinë e çelësit.
<input type="checkbox"/>	<b>Rezistenca e izolimit</b> të kompresorit është NË RREGULL.
<input type="checkbox"/>	NUK ka <b>përbërës të dëmtuar</b> ose <b>tuba të ngjeshur</b> në pjesën e brendshme të njësive të brendshme dhe jashtme.
<input type="checkbox"/>	NUK ka <b>rrjedhje të ftohësit</b> .
<input type="checkbox"/>	Madhësia e duhur e tubit instalohet dhe <b>tubat</b> izolohehen siç duhet.
<input type="checkbox"/>	<b>Valvulet e ndalimit</b> (gazit dhe lëngjeve) në njësinë e jashtme janë plotësisht të hapura.

## 9.2 Kryerja e një testimi

Kjo detyrë zbatohet vetëm kur përdorni ndërfaqen e përdoruesit BRC1E52.

- Kur përdorni BRC1E51, shikoni manualin e instalimit të ndërfaqes së përdoruesit.
- Kur përdorni BRC1D, shikoni manualin e shërbimit të ndërfaqes së përdoruesit.





**NJOFTIM**

MOS e ndërpriti testimin.



**INFORMACION**

**Drita e pasme.** Për të kryer një veprim FIKJE/NDEZJE në ndërfaqen e përdoruesit, drita e pasme nuk ka pse të jetë e ndezur. Për çdo veprim tjetër, duhet të ndizet së pari. Drita e pasme qëndron e ndezur ±30 sekonda kur shtyp butonin.

**1 Kryej hapat hyrës.**

#	Veprimi
1	Hapni valvulin e ndalimit të ujit dhe valvulin e ndalimit të gazit duke hequr kapakun e avullit dhe duke e kthyer në drejtim të kundërt me akrepat e orës me një çelës heks derisa të ndalojë.
2	Mbyll kapakun e shërbimit për të parandaluar goditjet elektrike.
3	NDIZ energjinë për të paktën 6 orë para fillimit të përdorimit për të mbrojtur kompresorin.
4	Në ndërfaqen e përdoruesit, caktoje njësinë në modalitetin e përdorimit të ftohjes.

**2 Filloni një testim.**

#	Aksioni	Rezultati
1	Shkoni te menya kryesore.	
2	Shtypni për të paktën 4 sekonda.	Shfaqet menya Service Settings . 
3	Zgjidhni Test Operation.	
4	Shtypni.	Test Operation shfaqet në menyën kryesore. 
5	Shtypni për 10 sekonda.	Fillon testimi.

**3 Kontrolloni operimin për 3 minuta.**

**4 Kontrolloni operimin e drejtimit të qarkullimit të ajrit.**

#	Aksioni	Rezultati
1	Shtypni.	

#	Aksioni	Rezultati
2	Zgjidhni Position 0. 	
3	Ndryshoni pozicionin. 	Nëse fleta e qarkullimit të ajrit të njësisë së brendshme lëviz, operimi është NË RREGULL.  Nëse jo, operimi nuk është NË RREGULL.
4	Shtypni. 	Shfaqet menya kryesore.

**5 Ndalo testimin.**

#	Veprimi	Rezultati
1	Shtyp të paktën 4 sekonda.	Shfaqet menya Service Settings.
2	Përzgjidh Test Operation. 	
3	Shtyp. 	Njësia kthehet në operacionin normal dhe shfaqet menya kryesore.

**9.3 Kodet e gabimit kur kryen testimin**

Nëse instalimi i njësisë së jashtme NUK është kryer si duhet, në ndërfaqen e përdoruesit mund të shfaqen kodet vijuese të gabimit:

Kodi i gabimit	Shkaku i mundshëm
Nuk është shfaqur asgjë (temperatura e caktuar aktualisht nuk shfaqet)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Instalimi elektrik është i shkëputur ose ka një gabim (mes furnizimit me energji elektrike dhe njësisë së jashtme, mes njësisë së jashtme dhe njësisë të brendshme, mes njësisë së brendshme dhe ndërfaqes së përdoruesit).</li> <li>Siguresa në njësinë PCB të jashtme është prishur.</li> </ul>
E3, E4 ose L8	<ul style="list-style-type: none"> <li>Valvulet e ndalimit janë mbyllur.</li> <li>Pjesa hyrëse dhe dalje e ajrit është e bllokuar.</li> </ul>
E7	Në rastin e njësive të furnizimit me energji elektrike me tre faza, njëra nga fazat mungon.  <b>Shënim:</b> Operimi do të ishte i pamundur. FIKNI energjinë, rikontrolloni instalimet elektrike, dhe ndërroni dy nga telat elektrikë.
L4	Pjesa hyrëse dhe dalje e ajrit është e bllokuar.
U0	Valvulet e ndalimit janë mbyllur.

## 10 Hedhja

Kodi i gabimit	Shkaku i mundshëm
U2	<ul style="list-style-type: none"><li>Ka një mungesë ekuilibri të voltazhit.</li><li>Në rastin e njësive të furnizimit me energji elektrike me tre faza, njëra nga fazat mungon. <b>Shënim:</b> Operimi do të ishte i pamundur. FIKNI energjinë, rikontrolloni instalimet elektrike, dhe ndërroni dy nga telat elektrikë.</li></ul>
U4 ose UF	Instalimet elektrike të degëzimit ndërmjet njësive nuk janë të sakta.
UA	Njësia e jashtme dhe e brendshme nuk përputhen.



### NJOFTIM

- Detektori i mbrojtjes së fazës së ndryshuar të këtij produkti funksionon vetëm kur vihet në punë produkti. Rrjedhimisht kapja e fazës së ndryshuar nuk kryhet gjatë operimit normal të produktit.
- Detektori i mbrojtjes së fazës së ndryshuar është projektuar ta ndalojë produktin në rastin e një anomalie kur produkti vihet në punë.
- Zëvendësoni 2 nga 3 fazat (L1, L2, and L3) gjatë anomalisë së mbrojtjes së fazës së ndryshuar.

## 10 Hedhja

Kjo njësi përdor hidrofluorokarbon. Kontakto shitësin tënd kur hedh këtë njësi. Ligji kërkon mbledhjen, transportimin dhe hedhjen e ftohësit në përputhje me rregullat e "mbledhjes dhe shkatërrimit të hidrofluorokarbonit".



### NJOFTIM

MOS provoni ta çmontoni vetë sistemin: çmontimi i sistemit, menaxhimi i ftohësit, vajit dhe pjesëve të tjera DUHET të përputhet me legjislacionin në fuqi. Njësitë DUHET të trajtohen në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim.

## 11 Të dhënat teknike

Një nëngrup i të dhënave më të fundit teknike ofrohet në faqen rajonale të internetit të Daikin (e aksesueshme nga publiku). **Seti i plotë** i të dhënave më të fundit teknike ofrohet në Daikin Business Portal (kërkohet autentikim).

### 11.1 Hapësira e shërbimit: Njësia e jashtme

<b>Ana e thithjes</b>	Në ilustrimet në brendësi të kopertinës para të këtij manuali, hapësira e shërbimit në anën thithëse bazohet në 35°C DB dhe operimin e ftohjes. Parashikoni më shumë hapësirë në rastet vijuese: <ul style="list-style-type: none"> <li>Kur temperatura e anës së thithjes tejkalon rregullisht këtë temperaturë.</li> <li>Kur ngarkesa e nxehtësisë të njësive të jashtme pritet të tejkalojë rregullisht kapacitetin maksimal të operimit.</li> </ul>
<b>Ana e shkarkimit</b>	Merrni parasysh punën e tubacionit të ftohësit kur poziciononi njësitet. Nëse plani yt nuk përputhet me planet më poshtë, kontaktoni shitësin tuaj.

#### Njësi teke (□) | Rresht tek njësish (←→)

→ Shikoni "figurën 1" [p. 2] në brendësi të kopertinës para të këtij manuali.

- A,B,C,D** Pengesat (mure/pllaka panelesh)
- E** Pengesa (çati)
- a,b,c,d,e** Hapësirë minimale shërbimi mes njësive dhe pengesave A, B, C, D dhe E
- e<sub>a</sub>** Distanca maksimale mes njësive dhe buzës së pengesës E, në drejtim të pengesës B
- e<sub>b</sub>** Distanca maksimale mes njësive dhe buzës së pengesës E, në drejtim të pengesës D
- H<sub>U</sub>** Lartësia e njësive
- H<sub>B</sub>,H<sub>D</sub>** Lartësia e pengesave B dhe D
- 1** Vulosni fundin e skeletit të instalimit për të penguar ajrin e shkarkimit nga kthimi në krahun e thithjes përmes fundit të njësive.
- 2** Maksimumi dy njësi mund të instalohen.  
Nuk lejohet

#### Rreshta të shumtë njësish (□□□□)


→ Shikoni "figurën 2" [p. 2] në brendësi të kopertinës para të këtij manuali.

#### Njësitet e grumbulluara (maks. 2 nivele) (□□□□)

→ Shikoni "figurën 3" [p. 2] në brendësi të kopertinës para të këtij manuali.

- A1=>A2** (A1) Nëse ka rrezik pikimi të kullimit dhe ngrirje mes njësive të sipërme dhe të poshtme...  
(A2) Atëherë instaloni një **çati** mes njësive të sipërme dhe të poshtme. Instaloni njësine e sipërme aq lart mbi njësine e poshtme sa që të pengohet grumbullimi i akullit në pllakën fundore të njësive të sipërme.
- B1=>B2** (B1) Nëse nuk ka rrezik pikimi të kullimit dhe ngrirje mes njësive të sipërme dhe të poshtme...  
(B2) Atëherë nuk kërkohet instalimi i një çatie, por **vulosni hapësirën** mes njësive të sipërme dhe të poshtme për të penguar ajrin e shkarkuar nga kthimi në krahun e thithjes përmes fundit të njësive.

11.2 Diagrami i tubacionit: Njësia e jashtme



3D146949A

	Porta e ngarkimit / Porta e shërbimit (me 5/16" ngjeshje)		Kompresori
	Valvuli ndalimi		Distributori
	Filtri		Marrësi i lëngjeve
	Valvuli i kontrollit		Lidhje me ngjeshje
	Valvuli solenoid	<b>A</b>	Tubacioni në terren (lëng: Ø9,5 lidhje me ngjeshje)
	Thithësja e nxehtësisë (PCB)	<b>B</b>	Tubacioni në terren (gaz: Ø15,9 lidhje me ngjeshje)
	Tubi kapital		Ngrohja
	Valvuli i zgjerimit elektronik		Ftohja
	Valvuli me 4-rrugë		
	Çelësi i presionit të lartë		
	Çelës me presion të ulët		
	Akumulues kompresori		
	Shkëmbyesi i ngrohjes		

## 11.3 Diagrami i instalimeve: Njësia e jashtme

Diagrami i instalimeve elektrike dorëzohet bashkë me njësinë, i cili gjendet në brendësi të kapakut të shërbimit.








### (1) Diagrami i lidhjes

Anglisht	Përkthimi
Connection diagram	Diagrami i lidhjes
Only for ***	Vetëm për ***
See note ***	Shikoni shënimin ***
Outdoor	Jashtë
Indoor	Brenda
Upper	E sipërme
Lower	E ulët
Fan	Ventilatori
ON	NDEZUR
OFF	FIKUR

### (2) Plani

Anglisht	Përkthimi
Layout	Plani
Front	Para
Back	Prapa
Position of compressor terminal	Pozicioni i terminalit të kompresorit

### (3) Shënime

Anglisht	Përkthimi
Notes	Shënime
	Lidhja
X1M	Komunikimi brenda/jashtë
-----	Instalimet e tokëzimit
-----	Furnizuar nga instaluesi
①	Disa mundësi të instalimeve elektrike
	Tokëzimi mbrojtës
	Tel terreni
	Instalime elektrike në varësi të modelit
	Opsioni
	Kutia e ndërrimit
	PCB

#### SHËNIME:

- Referojuni afishes së diagramit të instalimeve elektrike (në pjesën e pasme të pllakës para) për mënyrën e përdorimit të BS1~BS3 dhe çelësave DS1.
- Kur operohet, mos krijoni qark të shkurtër për pajisjes mbrojtëse S1PH S1PL dhe Q1E.
- Referojuni tabelës së kombinimit dhe manualit të opsioneve për mënyrën si të lidhni instalimet elektrike me X6A, X28A dhe X77A.
- Ngjyrat: BLK: e zezë, RED: e kuqe, BLU: blu, WHT: e bardhë, GRN: jeshile, YLW: e verdhë.

### (4) Legjenda

Anglisht	Përkthimi
Legend	Legjenda
Field supply	Furnizuar nga instaluesi
Optional	Opsionale

Anglisht	Përkthimi
Part n°	Pjesa n°
Description	Përshkrimi

A1P	Dërrasa e shtypur e qarkut (kryesor)
A2P	Dërrasa e shtypur e qarkut (filtër për zhurmën)
BS1~BS3 (A1P)	Çelësi i butonit të shtypjes në PCB
C* (A1P) (Y vetëm)	Kondensatori
DS1 (A1P)	Çelësi DIP
E* (A1P)	Terminali (tokëzim i qetë)
F*U	Siguresa
H*P (A1P)	Diodë që lëshon dritë (monitori i shërbimit është jeshil)
K1M, K3M (A1P) (Y vetëm)	Kontaktuesi magnetik
K1R (A1P)	Rele magnetike (Y1S)
K2R (A1P)	Rele magnetike (Y2S)
K10R, K13R~K15R (A1P)	Rele magnetike
K11M (A1P) (V vetëm)	Kontaktuesi magnetik
L* (A1P)	Terminali (live)
L1R (Y vetëm)	Reaktor
M1C	Motori i kompresorit
M1F	Motori i ventilatorit
N* (A1P)	Terminali (neutral)
PFC (A1P) (V vetëm)	Korrigjimi i faktorit të energjisë
PS (A1P)	Ndërrimi i energjisë
Q1	Mbrojtja në rast mbingarkese
Q1DI	Çelësi i qarkut për rrjedhje të tokëzuar (30 mA)
R1~R8 (A1P) (Y vetëm)	Rezistencë
R1T	Ajër termistor (ajër)
R2T	Termistor (zbrazni)
R3T	Termistor (thitje)
R4T	Termistori (shkëmbyes energjie)
R5T	Termistori (në person ndërmjetës)
R6T	Termistori (lëng)
R7T	Termistori (fletë)
R8T~R10T (A1P)	Termistori (PTC)
R11T (A1P) (vetëm Y)	Termistori (PTC)
R501~R962 (A1P) (vetëm V)	Rezistencë
R2~R981 (A1P) (vetëm Y)	Rezistencë
R*V (A2P) (vetëm V)	Varistori
S1PH	Çelësi i presionit të lartë
S1PL	Çelës me presion të ulët
SEG* (A1P)	Ekran me 7 segmente
TC1 (A1P)	Qarku i transmetimit të sinjalit
V1D (A1P) (V vetëm)	Dioda
V1D~V2D (A1P) (Y vetëm)	Dioda

## 11 Të dhënat teknike

---

V*R (A1P)	Moduli i diodës / moduli i energjisë IGBT
X*A	Lidhësi
X1M	Rripi i terminalit
Y1E, Y3E	Valvul i zgjerimit elektronik
Y1S	Valvuli solenoid (valvul me 4 rrugë)
Y2S	Valvuli solenoid (marrësi i gazit)
Z*C	Filtri i zhurmës (bërthama ferrite)
Z*F	Filtër zhurme
L*, L*A, L*B, NA, NB, E*, U, V, W, X*A (A1P~A2P)	Lidhësi



ERC



4P734658-1 B 00000004

Copyright 2023 Daikin

**DAIKIN EUROPE N.V.**

Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende, Belgium

4P734658-1B 2024.05